

Direktiva nr. 1999/93/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 1999, mbi një kuadër komunitar për nënshkrimin elektronik

Gazeta Zyrtare L 103, 19/01/2000 fq. 0012 - 0020

Direktiva nr. 1999/93/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 1999, mbi një kuadër komunitar për nënshkrimin elektronik

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Në bazë të Traktatit Themelues të Komunitetit European, në veçanti nenet 47 pika 2, 55 dhe 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke pasur parasyh opinionin e Komitetit të Rajoneve [3],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [4],

Duke pasur parasysh se:

(1) Më datë 16 prill 1997 Komisioni i paraqiti Parlamentit European, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve një komunikatë mbi nismën europiane për tregtinë elektronike;

(2) Më datë 8 tetor 1997 Komisioni i paraqiti Parlamentit European, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve një komunikatë mbi arritjen e sigurimit dhe besimit në fushën e komunikimit elektronik, drejt një kuadri european për nënshkrimet digjitale dhe shifrimin;

(3) Më datë 1 dhjetor 1997 Këshilli kërkoi Komisionit të paraqesë sa më shpejt një propozim për një direktivë të Parlamentit European dhe të Këshillit për nënshkrimet digjitale;

(4) Komunikimi elektronik dhe tregtia kanë nevojë për “nënshkrimet elektronike” dhe shërbimet e lidhura me to, për të mundësuar vërtetimin e të dhënave; rregullat e ndryshme në lidhje me njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike dhe akreditimin e ofruesve të shërbimit të certifikimit në Shtetet Anëtare mund të krijojnë një pengesë të ndjeshme për përdorimin e komunikimit elektronik dhe tregtinë elektronike; nga ana tjetër, një kuadër i qartë i Komunitetit në lidhje me kushtet që zbatohen për nënshkrimet elektronike rrisin besimin dhe pranimin e përgjithshëm të teknologjive të reja; legjislacioni i Shteteve Anëtare të mos e pengojë lëvizjen e mirë të mallrave dhe shërbimeve në tregun e brendshëm;

(5) Duhet promovuar ndërveprueshmëria e produkteve të nënshkrimit elektronik; në përputhje me nenin 14 të Traktatit, tregu i brendshëm përfshin një zonë pa kufij të brendshëm në të cilin sigurohet lëvizja e lirë e mallrave; duhen përmbushur kërkesat thelbësore që janë specifike për produktet e nënshkrimeve elektronike, në mënyrë që të sigurohet lëvizja e lirë në tregun e brendshëm dhe të forcohet besimi tek nënshkrimet elektronike, pa cenuar Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 3381/94, datë 19 dhjetor 1994, për krijimin e një regjimi të Komunitetit për kontrollin e eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë [5] dhe Vendimin e Këshillit nr. 94/942/PPJS, datë 19

dhjetor 1994, për veprimin e përbashkët të miratuar nga Këshilli për kontrollin e eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë [6];

(6) Kjo direktivë nuk harmonizon dispozitën për ofrimin e shërbimeve në lidhje me ruajtjen e informacionit konfidencial, kur këto shërbime mbulohen nga dispozitat kombëtare që lidhen me politikën publike ose sigurimin publike;

(7) Tregu i brendshëm siguron lëvizjen e lirë të personave, si rezultat i së cilës qytetarët dhe personat me banim në Bashkimin Europian gjithnjë e më shumë u duhet të kenë të bëjnë me autoritetet në Shtete Anëtare të tjera krahas Shtetit Anëtar ku banojnë vetë; në lidhje me këtë, mundësia e përdorimit të komunikimit elektronik ka një vlerë të madhe;

(8) Zhvillimi i vullshëm teknologjik dhe natyra globale e internetit kërkojnë një përjasje, e cila është e hapur ndaj teknologjike dhe shërbimeve të ndryshme të afta të vërtetojnë origjinalitetin e të dhënave në mënyrë elektronike;

(9) Nënshkrimet elektronike përdoren në një shumëllojshmëri të madhe rrethanash dhe aplikimesh, duke çuar në një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh të reja që kanë lidhje me nënshkrimet elektronike ose që i përdorin këto të fundit; përkufizimi i produkteve dhe shërbimeve të tilla nuk duhet të kufizohet me lëshimin dhe menaxhimin e certifikatave, por të përfshijë edhe çdo shërbim dhe produkt tjetër i cili përdor ose mbështetet te nënshkrimet elektronike, siç janë shërbimet e regjistrimit, shërbimet e regjistrimit të orarit, shërbimet e adresarëve, shërbimet e kompjuterizuara ose shërbimet e konsulencës të lidhura me nënshkrimet elektronike;

(10) Tregu i brendshëm u mundëson ofruesve të shërbimeve të certifikimit të zhvillojnë aktivitetet e tyre ndërkufitare, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë për t'u ofruar kështu mundësi të reja klientëve dhe bizneseve për të shkëmbyer informacion dhe tregtuar në mënyrë elektronike në mënyrë të sigurt, pa u penguar nga kufijtë; për të nxitur një ofrim të shërbimeve të komunikimit përmes rrjeteve të hapura në mbarë Komunitetin, ofruesit e shërbimeve të certifikimit duhet t'i ofrojnë shërbimet e tyre pa autorizim paraprak; autorizim paraprak do të thotë jo vetëm çdo leje përmes të cilës ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet të marrë një vendim nga autoritetet kombëtare përpara se t'i lejohet të ofrojë shërbimet e veta të certifikimit, por edhe çdo masë tjetër me të njëjtin efekt;

(11) Skemat vullnetare të akreditimit, që synojnë rritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve, mund t'u sigurojnë ofruesve të shërbimeve të certifikimit kuadrin e duhur për t'i zhvilluar më tej shërbimet e tyre për të arritur atë nivel besimi, sigurimi dhe cilësie që kërkon tregu në zhvillim e sipër; skema të tilla të nxisin zhvillimin e praktikave të mira të ofruesit e shërbimeve të certifikimit; ofruesit e shërbimeve të certifikimit të lihen të lirë të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga skema të tilla akreditimi;

(12) Shërbimet e akreditimit mund të ofrohen ose nga një subjekt publik ose nga një person fizik ose juridik, nëse krijohen sipas të drejtës kombëtare; ndërsa Shtetet Anëtare nuk duhet t'i ndalojnë ofruesit e shërbimeve të certifikimit që të kryejnë funksionet e tyre jashtë skemave vullnetare të akreditimit; duhet siguruar që skema të tilla akreditimi të mos e ulin konkurrencën për shërbimet e certifikimit;

(13) Shtetet Anëtare mund të marrin vendime për mënyrën se si të sigurojnë mbikëqyrjen e përmbushjes së dispozitave të parashikuara në këtë direktivë; kjo direktivë nuk e pengon krijimin e sistemeve të mbikëqyrjes të mbështetur në sektorin privat; kjo direktivë nuk i detyron ofruesit e shërbimeve të certifikimit të paraqesin kërkesë për t'u mbikëqyrur sipas cilësdo prej skemave të aplikueshme të akreditimit;

(14) Është e rëndësishme të vendoset një ekuilibër midis nevojave të konsumatorëve dhe të bizneseve;

(15) Shtojca III mbulon kërkesat për aparatet e krijimit të nënshkrimeve të sigurta për të siguruar funksionimin e nënshkrimeve elektronike të avancuara; ai nuk e mbulon të gjithë mjedisin e sistemit në të cilin funksionojnë këto aparate; funksionimi i tregut të brendshëm e detyron Komisionin dhe Shtetet Anëtare të veprojnë me shpejtësi për t'u dhënë mundësi organeve të ngarkuara me vlerësimin e përputhjes së aparateve të nënshkrimeve të sigurta, me kërkesat e Shtojcës III që të përcaktohen; për të përmbushur nevojat e tregut, vlerësimi i përmbushjes së kërkesave ligjore duhet të realizohet në kohë dhe me efikasitet;

(16) Kjo direktivë kontribuon në përdorimin dhe njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike brenda Komunitetit; nuk nevojitet një kuadër rregullues për nënshkrimet elektronike që përdoren vetëm brenda sistemeve, të cilat mbështeten në aktmarrëveshje vullnetare në kuadër të së drejtës private ndërmjet një numri të përcaktuar pjesëmarrësish; duhet të respektohet liria e palëve për të rënë në marrëveshje mes tyre, në lidhje me kushtet sipas cilave pranojnë të dhëna të nënshkruara në mënyrë elektronike, për aq sa lejohet nga e drejta kombëtare; është mirë të pranohet efektshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike të cilat përdoren në sisteme të tilla dhe pranueshmëria e tyre si provë gjyqësore në procedime ligjore;

(17) Kjo direktivë nuk kërkon të harmonizojë rregullat kombëtare të cilat kanë të bëjnë me legjislacionin për kontratat, me hartimin dhe realizimin e kontratave, ose formalitete të tjera të natyrës jokontraktuale, të cilat kanë të bëjnë me nënshkrimet; për këtë arsye, dispozitat që kanë të bëjnë me efektin ligjor të nënshkrimeve elektronike nuk cenojnë kërkesat ligjore që lidhen me formën, të parashikuara në të drejtën kombëtare për lidhjen e kontratave ose rregullat që përcaktojnë nëse është lidhur apo jo një kontratë;

(18) Ruajtja dhe kopjimi i të dhënave të krijimit të nënshkrimeve mund të përbëjnë një kërcënim ndaj vlefshmërisë ligjore të nënshkrimeve elektronike;

(19) Nënshkrimet elektronike përdoren në sektorin publik brenda administratave kombëtare dhe të Komunitetit, dhe gjatë komunikimeve midis këtyre administratave dhe qytetarëve dhe subjekteve ekonomike, për shembull në sistemet e prokurimeve publike, të tatim-taksave, të sigurimeve shoqërore, të shëndetësisë dhe të drejtësisë;

(20) Kriteret e harmonizuara, që lidhen me efektet ligjore të nënshkrimeve elektronike, ruajnë një kuadër ligjor koherent në mbarë Komunitetin; e drejta kombëtare parashikon kërkesat e ndryshme për vlefshmërinë ligjore të nënshkrimeve të hedhura me dorë; ndërkohë që certifikatat mund të përdoren për të konfirmuar identitetin e një personi që hedh firmë në formë elektronike; nënshkrimet elektronike të avancuara, të cilat mbështeten në certifikatat e kualifikuara, synojnë një nivel më të lartë sigurie; nënshkrimet elektronike të avancuara, të cilat mbështeten në një certifikatë të avancuar dhe të cilat krijohen përmes një aparati të krijimit të nënshkrimit të sigurt, mund të konsiderohen si të barasvlershme ligjorisht me nënshkrimet e hedhura me dorë, vetëm nëse janë përmbushur kërkesat ligjore për nënshkrimet e hedhura me dorë;

(21) Për të ndihmuar në pranimin e përgjithshëm të metodave elektronike të vërtetimit, duhet treguar kujdes që nënshkrimet elektronike të mund të përdoren si prova gjyqësore në procedime ligjore në të gjitha Shtetet Anëtare; njohja ligjore e nënshkrimeve elektronike duhet të mbështetet në kritere objektive dhe të mos lidhet me autorizimin e ofruesit të shërbimeve të certifikimit të përfshirë në proces; e drejta kombëtare rregullon sferat ligjore në të cilat mund të përdoren dokumentet elektronike dhe nënshkrimet elektronike; kjo direktivë nuk cenon kompetencën e një gjykate kombëtare për të marrë vendim në lidhje me përmbushjen e kërkesave të kësaj direktive, dhe nuk ndikon rregullat kombëtare në lidhje me marrjen në shqyrtim në mënyrë të papenguar të provave gjyqësore;

(22) Ofruesit e shërbimeve të certifikimit, të cilët i ofrojnë publikut shërbimeve certifikimi, u nënshtrohen rregullave kombëtare për përgjegjësinë ligjore;

(23) Zhvillimi i tregtisë elektronike ndërkombëtare kërkon masa organizuese ndërkufitare të cilat përfshijnë vende të treta; për të siguruar ndërveprueshmërinë në nivel global, mund të ndihmojnë aktmarrëveshjet për rregullat shumëpalëshe me vendet e treta për njohjen e ndërsjellë të shërbimeve të certifikimit;

(24) Për të rritur besimin e përdoruesve të komunikimi elektronik dhe tregtia elektronike, ofruesit e shërbimeve të certifikimit duhet të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave si edhe jetës private të individit;

(25) Dispozitat për përdorimin e pseudonimeve në certifikata nuk duhet të pengojnë Shtetet Anëtare të kërkojnë identifikimin e personave sipas të drejtës së Komunitetit ose të vendit;

(26) Duhet miratuar masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive në përputhje me Vendimin e Këshillit nr. 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, që parashikon procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që jep Komisioni [7];

(27) Dy vjet pas zbatimit të saj, Komisioni kryen një rishikim të kësaj direktive në mënyrë që të kujdeset, inter alia, që përparimi i teknologjisë ose ndryshimet në mjedisin ligjor të mos kenë krijuar pengesa në arritjen e synimeve të parashikuara në këtë direktivë; është mirë të shqyrtohen rrjedhojat e fushave të lidhura teknike dhe t'i paraqitet një raport Parlamentit European dhe Këshillit në lidhje me këtë temë;

(28) Në përputhje me parimet e subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit të parashikuar në nenin 5 të Traktatit, objektivi i krijimit të një kuadri ligjor të harmonizuar për ofrimin e nënshkrimeve elektronike dhe shërbimeve të lidhura me to nuk mund të arrihet mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare dhe, për rrjedhojë, mund të arrihet më mirë nga Komuniteti; kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur këtë objektiv,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Qëllimi i kësaj direktive është që të ndihmojë në përdorimin e nënshkrimeve elektronike dhe njohjen e tyre ligjore . Në të përcaktohet kuadri ligjor për nënshkrimet elektronike dhe disa shërbime të caktuara të certifikimit për të garantuar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm.

Në të nuk trajtohen aspektet të cilat kanë të bëjnë me lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratave apo me detyrimet e tjera ligjore, në rastet kur ka kërkesa ligjore për formën të cilat përcaktohen nga e drejta kombëtare ose komunitare. Kjo direktivë nuk prek rregullat dhe kufizimet në të drejtën kombëtare ose komunitare që rregullon përdorimin e dokumenteve.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj direktive:

1. “nënshkrimi elektronik” nënkupton të dhëna në formë elektronike të cilat u bashkëlidhen ose shoqërohen logjikisht me të dhëna të tjera elektronike, dhe të cilat shërbejnë si metodë vërtetimi;

2. “nënshkrimi elektronik i avancuar” nënkupton një nënshkrim elektronik i cili përmbush kërkesat e mëposhtme:

(a) lidhet me nënshkruesin në mënyrë unike;

(b) ka aftësinë të identifikojë nënshkruesin;

(c) krijohet me mjete të cilat mund t'i mbajë nën kontroll vetëm nënshkruesi; dhe

(d) lidhet me të dhënat me të cilat ka të bëjë në mënyrë të atillë që të mund të jetë i diktueshëm çdo ndryshim i mëpasshëm i këtyre të dhënave;

3. “nënshkruesi” nënkupton një person i cili ka një aparat të krijimit të nënshkrimeve dhe i cili vepron ose në emër të tij ose në emër të personit fizik, ose juridik që përfaqëson;

4. “të dhëna krijuese të nënshkrimeve” nënkuptojnë të dhënat unike, si për shembull kode ose çelësa kriptografikë privatë, të cilat përdoren nga nënshkruesi për të krijuar një nënshkrim elektronik;

5. “aparati i krijimit të nënshkrimeve” nënkupton softuer ose harduer i konfiguruar i cili përdoret për të vënë në zbatim të dhënat krijuese të nënshkrimeve;

6. “aparati i krijimit të nënshkrimit të sigurt” nënkupton aparati i krijimit të nënshkrimeve e cila përmbush kërkesat e parashikuara në Shtojcën III;

7. “të dhënat e verifikimit të nënshkrimeve” nënkuptojnë të dhënat, si për shembull kode ose çelësa kriptografikë publikë, të cilat përdoren me qëllim verifikimin e një nënshkrimi elektronik;

8. “aparati i verifikimit të nënshkrimeve” nënkupton mjete të trupëzuar ose të patrupëzuar i konfiguruar i cili përdoret për të vënë në zbatim të dhënat verifikuese të nënshkrimeve;

9. “certifikata” nënkupton një vërtetim elektronik i cili bën lidhjen midis të dhënave verifikuese të nënshkrimit me një person dhe konfirmon identitetin e këtij personi;

10. “certifikata e kualifikuar” nënkupton certifikata e cila përmbush kërkesat e parashikuara në Shtojcën I dhe ofrohet nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit i cili përmbush kërkesat e parashikuara në Shtojcën II;

11. “ofruesi i shërbimeve të certifikimit” nënkupton një subjekt ose person fizik ose juridik i cili lëshon certifikata ose ofron shërbime të tjera të lidhura me nënshkrimet elektronike;

12. “produkti i nënshkrimit elektronik” nënkupton softuer ose harduer, ose pjesë përbërëse të tij, të cilat përdoren nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit për ofrimin e shërbimeve të nënshkrimeve elektronike, ose të cilat përdoren për krijimin ose verifikimin e nënshkrimeve elektronike;

13. “akreditimi vullnetar” nënkupton lejen e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet konkrete të ofrimit të shërbimeve të certifikimit e cila jepet sipas kërkesës së ofruesit në fjalë të shërbimeve të certifikimit nga organi publik ose privat i ngarkuar me përcaktimin dhe mbikëqyrjen e përputhjes së këtyre të drejtave dhe detyrimeve, kur ofruesi i shërbimeve të certifikimit nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga leja derisa të ketë marrë vendimin nga organi në fjalë.

Neni 3 Hyrja në treg

1. Shtetet Anëtare nuk ia nënshtrojnë ofrimin e shërbimeve të certifikimit kërkesës për autorizim paraprak.

2. Pa zhvleftësuar dispozitat e paragrafit 1, Shtetet Anëtare mund të fusin në përdorim ose të mbajnë skema vullnetare të akreditimit me synim rritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve të certifikimit. Të gjitha kushtet e lidhura me skema të tilla duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe mosdiskriminuese. Shtetet Anëtare nuk mund ta kufizojnë numrin e ofruesve të akredituar të shërbimeve të certifikimit për arsye të cilat bien në objektin e kësaj direktive.

3. Çdo Shtet Anëtar kujdeset për krijimin e një sistemi të përshtatshëm i cili mundëson mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të certifikimit të krijuar në territorin e vet, dhe të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara për publikun.

4. Përputhshmëria e aparateve të sigurta të krijimit të nënshkrimeve me kërkesat e parashikuara në Shtojcën III, përcaktohet nga organet e përshtatshme publike ose private të caktuara nga Shtetet Anëtare. Sipas procedurës të parashikuar në nenin 9, Komisioni vendos kriteret për Shtetet Anëtare për të marrë vendim nëse duhet caktuar apo jo një organ i tillë.

Vendimi në lidhje me përmbushjen e kërkesave të parashikuara në Shtojcën III i marrë nga organet e përmendura në nënparagrafin e parë pranohet nga të gjitha Shtetet Anëtare.

5. Në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 9, Komisioni mund të vendosë dhe të publikojë numra reference të standardeve të pranuar gjerësisht për produktet e nënshkrimeve elektronike në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane. Shtetet Anëtare prezumojnë se ekziston përmbushja e kërkesave të parashikuara në Shtojcën II, pika (f), dhe në Shtojcën III kur një produkt i nënshkrimeve elektronike i përmbush këto standarde.

6. Shtetet Anëtare dhe Komisioni punojnë së bashku për të nxitur zhvillimin dhe përdorimin e aparateve verifikuese të nënshkrimeve në bazë të rekomandimeve për verifikimin e sigurt të nënshkrimeve të parashikuara në Shtojcën IV dhe në interes të klientit.

7. Shtetet Anëtare mund t'i përdorin nënshkrimet elektronike në sektorin publik duke iu nënshtruar kërkesave ligjore shtesë. Këto kërkesa janë objektive, transparente, proporcionale dhe mosdiskriminuese dhe kanë lidhje vetëm me karakteristikat konkrete të aplikimit në fjalë. Këto kërkesa nuk mund të përbëjnë pengesë për shërbimet ndërkuftare për qytetarët.

Neni 4

Parimet e tregut të brendshëm

1. Secili Shtet Anëtar zbaton dispozitat kombëtare të cilat i miraton sipas kësaj direktive për certifikimin e ofruesve të shërbimeve të certifikimit të themeluar në territorin e vet dhe për shërbimet e ofruara prej tyre. Shtetet Anëtare nuk mund ta kufizojnë ofrimin e shërbimeve të certifikimit me origjinë nga një Shtet Anëtar tjetër në fushat e mbuluara nga kjo direktivë.

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që produktet e nënshkrimeve elektronike të cilat përmbushin dispozitat e kësaj direktive të lejohen të qarkullojnë lirshëm në tregun e brendshëm.

Neni 5

Efektet ligjore të nënshkrimeve elektronike

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që nënshkrimet e avancuara elektronike të cilat mbështeten në një certifikatë të kualifikuar dhe të cilat krijojnë me anë të një aparati të krijimit të nënshkrimeve të sigurta:

(a) të përmbushin kërkesat ligjore të një nënshkrimi në lidhje me të dhënat në formë elektronike në të njëjtën mënyrë siç i përmbush këto kërkesa ligjore edhe nënshkrimi i hedhur me dorë në lidhje me të dhënat në letër; dhe

(b) të jenë të pranueshme si provë gjyqësore në proceset ligjore.

2. Shtetet Anëtare kujdesen që nënshkrimin elektronik të mos i mohohet fuqia ligjore dhe pranueshmëria si provë gjyqësore në proceset ligjore vetëm për arsye se është:

— në formë elektronike, ose

— jo i mbështetur, në një certifikatë të kualifikuar, ose

— jo i mbështetur në një certifikatë të kualifikuar e lëshuar nga një ofrues i akredituar i shërbimeve të certifikimit, ose

— jo i krijuar me anë të një aparati të sigurt të krijimit të nënshkrimeve.

Neni 6

Përgjegjësia ligjore

1. Së paku, Shtetet Anëtare sigurojnë që gjatë lëshimit të një certifikate si certifikatë e kualifikuar për publikun, ose gjatë garantimit të një certifikate të tillë për publikun, ofruesi i shërbimeve të certifikimit të mbajë përgjegjësi ligjore për dëmin e shkaktuar çdo subjekti ose personi fizik ose juridik që mbështet te certifikata në fjalë në mënyrë të arsyeshme:

(a) në lidhje me saktësinë në kohën e lëshimit të të gjithë informacioneve që përmban certifikata e kualifikuar dhe në lidhje me faktin që certifikata përmban të gjitha të dhënat e parashikuara për një certifikatë të kualifikuar;

(b) për të garantuar që në kohën e lëshimit të certifikatës, nënshkruesi i identifikuar në certifikatën e kualifikuar ka mbajtur të dhënat e krijimit të nënshkrimit të cilat u korrespondojnë të dhënave të verifikimit të nënshkrimit që jepen ose identifikohen në certifikatë;

(c) për të garantuar që të dhënat e krijimit të nënshkrimit dhe të dhënat e verifikimit të nënshkrimit mund të përdoren në plotësim të njëra tjetrës kur gjenerohen nga i njëjti ofrues i shërbimeve të certifikimit; me përjashtim të rasteve kur ofruesi i shërbimeve të certifikimit vërteton se nuk ka pasur pakujdesi nga ana e tij.

2. Së paku, Shtetet Anëtare sigurojnë që një ofrues i shërbimeve të certifikimit, që lëshon një certifikatë si certifikatë të kualifikuar për publikun, mban përgjegjësi ligjore për dëmin që i shkakton çdo subjekti ose personi fizik ose juridik, që mbështetet në mënyrë të arsyeshme në certifikatën për mosregjistrim revokimi të certifikatës, me përjashtim të rasteve kur ofruesi i shërbimeve të certifikimit vërteton se nuk ka pasur pakujdesi nga ana e tij.

3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ofruesi i shërbimeve të certifikimit mund të përcaktojë në një certifikatë të kualifikuar kufizime mbi përdorimin e certifikatës në fjalë, duke siguruar që këto kufizime janë të dallueshme nga palët e treta. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit nuk mban përgjegjësi ligjore për dëmet të shkaktuara nga përdorimi i certifikatës së kualifikuar që shkel kufizimet që vendosen mbi të.

4. Shtetet Anëtare sigurojnë që një ofrues i shërbimeve të certifikimit mund të përcaktojë në certifikatën e kualifikuar një kufi mbi vlerën e veprimeve për të cilën përdoret certifikata, duke siguruar që kufiri është i dallueshëm nga palët e treta.

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit nuk mban përgjegjësi ligjore për dëmet e shkaktuara nga tejkalimi i këtij kufiri maksimal.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 deri 4 nuk cenojnë Direktivën e Këshillit nr. 93/13/KEE, datë 5 prill 1993, për kushte të padrejta në kontrata konsumatore [8].

Neni 7

Aspektet ndërkombëtare

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që certifikatat e lëshuara si certifikata të kualifikuara për publikun nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit, të vendosur në një vend të tretë, njihen si ligjërish të barasvlershme me certifikatat e lëshuara nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit të vendosur në Komunitet nëse:

(a) ofruesi i shërbimeve të certifikimeve përmbush kërkesat e parashikuara në këtë direktivë dhe është akredituar sipas një skeme akreditimi vullnetare të vendosur në një Shtet Anëtar; ose

(b) një ofrues i shërbimeve të certifikimit i vendosur në Komunitet që përmbush kërkesat e parashikuara në këtë direktivë garanton certifikatën; ose

(c) certifikata ose ofruesi i shërbimeve të certifikimit njihet sipas një marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare.

2. Në mënyrë që të lehtësohen shërbimet ndërkufitare të certifikimit me vende të treta, dhe njohja ligjore e nënshkrimeve elektronike të avancuara me origjinë në vende të treta, Komisioni bën propozime, ku të jetë e përshtatshme, për të arritur ekzekutimin e efektshëm të standardeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme për shërbimet e certifikimit. Në veçanti, dhe ku është e nevojshme, ai i paraqet propozime Këshillit për kompetenca të përshtatshme për negocimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe me vende të treta dhe organizata ndërkombëtare. Këshilli vendos me shumicë të cilësuar.

3. Kurdo që Komisioni njoftohet për çdo vështirësi të hasur nga sipërmarrje komunitare, në lidhje me aksesin në tregjet e vendeve të treta, dhe nëse është e nevojshme, mund t'i paraqesë propozime Këshillit për kompetenca të përshtatshme për negocimin e të drejtave të krahasueshme për sipërmarrjet komunitare në këto vende të treta.

Masat e marra në zbatim të këtij paragrafi nuk cenojnë detyrimet e Komunitetit dhe të Shteteve Anëtare sipas marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të certifikimit dhe organet kombëtare përgjegjës për akreditimin ose mbikëqyrjen janë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Direktivën nr. 95/46/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 24 tetor 1995, për mbrojtjen me mbulim të individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla [9].

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që një ofrues i shërbimeve të certifikimit që lëshon certifikata për publikun mund të mbledhë të dhëna personale vetëm drejtpërdrejtë nga subjekti të cilit i përkasin të dhënat, ose me pëlqimin e dhënë të subjektit të cilit i përkasin të dhënat, dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për qëllimet e lëshimit dhe mirëmbajtjes së certifikatës. Të dhënat nuk duhet të mbledhen ose përpunohen për qëllime të tjera pa pëlqimin e dhënë të subjektit të cilit i përkasin të dhënat.

3. Pa cenuar efektet ligjore që gëzojnë pseudonimet sipas të drejtës kombëtare, Shteti Anëtar nuk pengon ofrues të shërbimeve të certifikimit që të përcaktojnë në certifikatë një pseudonim në vend të emrit të nënshkruesit.

Neni 9

Komiteti

1. Komisioni mbështetet nga një "Komitet për Nënshkrimin Elektronik", quajtur më poshtë "komiteti".
2. Në lidhje me këtë paragraf, nenet 4 dhe 7 të Vendimit nr. 1999/468/KE zbatohen duke pasur parasysh, dispozitat e nenit 8 të tij.

Periodha e parashikuar në nenin 4 pika 3 të Vendimit nr. 1999/468/KE është 3 muaj.

3. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

Neni 10

Detyrat e komitetit

Komiteti sqaron kërkesat e parashikuara në shtojcat e kësaj direktive, kriteret e përcaktuara në nenin 3 pika 4 dhe standardet e përgjithshme të pranura për produktet e nënshkrimit elektronik të përcaktuara dhe të shpallura në zbatim të nenit 3 pika 5, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 9 pika 2.

Neni 11

Njoftimi

1. Shtetet Anëtare bëjnë me dije përmes njoftimeve Komisionin dhe Shtetet Anëtare të tjera për:
 - (a) të dhëna për skemat kombëtare vullnetare të akreditimit, përfshirë edhe çdo kërkesë shtesë sipas nenit 3 pika 7;
 - (b) emrat dhe adresat e organeve kombëtare përgjegjëse për akreditimin dhe mbikëqyrjen si edhe të organeve të përmendura në nenin 3 pika 4;
 - (c) emrat dhe adresat e të gjithë ofruesve kombëtarë të akredituar të shërbimeve të certifikimit.
2. Të gjitha informacionet e dhëna sipas paragrafit 1 dhe ndryshimet në lidhje me këto informacione bëhen me dije nga ana e Shteteve Anëtare në rastin më të parë.

Neni 12

Shqyrtimi

1. Komisioni e shqyrton funksionimin e kësaj direktive dhe i raporton në lidhje me këtë Parlamentit Europian dhe Këshillit jo më vonë se data 19 korrik 2003.
2. Ndër të tjera, ky shqyrtim analizon nëse duhet ndryshuar apo jo objekti i kësaj direktive, në bazë të zhvillimeve teknologjike, ligjore dhe të tregut. Në veçanti, ky raport përfshin një analizë të aspekteve të harmonizimit në bazë të përvojës së fituar. Raporti, kur është e nevojshme, shoqërohet me propozime legjislative.

Neni 13

Zbatimi

1. Shtetet Anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë para datës 19 korrik 2001. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin. Me miratimin e këtyre masave, Shtetet Anëtare i referohen kësaj direktive ose i shoqërojnë këto dispozita me një referencë të publikimit të direktivës në Gazetën Zyrtare.. Mënyrat për të bërë një referencë të tillë përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të së drejtës së brendshme që miratojnë në fushën që rregullon kjo direktivë.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën e publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 15
Adresa

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 13 dhjetor 1999.

Për Parlamentin European

Presidenti

N. Fontaine
Për Këshillin

Presidenti

S. Hassi

[1] GZ C 325, 23.10.1998, fq. 5.

[2] GZ C 40, 15.02.1999, fq. 29.

[3] GZ C 93, 06.04.1999, fq. 33.

[4] Opinioni i Parlamentit European, datë 13 janar 1999 (GZ C 104, 14.4.1999, fq. 49), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 28 qershor 1999 (GZ C 243, 27.08.1999, fq. 33) dhe Vendimi i Parlamentit European, datë 27 tetor 1999 (i papublikuar ende në Gazetën Zyrtare).
Vendim i Këshillit, datë 30 nëntor 1999.

[5] GZ L 367, 31.12.1994, fq. 1. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 837/95 (GZ L 90, 21.4.1995, fq. 1).

[6] GZ L 367, 31.12.1994, fq. 8. Vendim i ndryshuar nga Vendimi 99/193/PPJS (GZ L 73, 19.03.1999, fq. 1).

[7] GZ L 184, 17.07.1999, fq. 23.

[8] GZ L 95, 21.04.1993, fq. 29.

[9] GZ L 281, 23.11.1995, fq. 31.

SHTOJCA I
Kërkesat ligjore për certifikatat e kualifikuara

Certifikatat e kualifikuara duhet të përmbajnë:

- (a) një shenjë që certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar;
- (b) identifikimin e ofruesit të shërbimit të certifikimit dhe shtetin ku është themeluar;
- (c) emrin e nënshkruesit ose një pseudonim, që identifikohet si i tillë;
- (d) parashikimin që të përfshihet një tipar specifik i nënshkruesit, nëse ka, në varësi të qëllimit për të cilin lëshohet certifikata;
- (e) të dhënat verifikuese të certifikatës të cilat u korrespondojnë të dhënave krijuese të certifikatës, të cilat janë në kontrollin e nënshkruesit;
- (f) fillimin dhe fundin e periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;
- (g) kodin identifikues të certifikatës;
- (h) nënshkrimin elektronik të avancuar të ofruesit të shërbimit të certifikimit i cili e ka lëshuar;
- (i) kufizimet e objektit të përdorimit të certifikatës, nëse ka; dhe
- (j) kufizimet e vlerës së transaksioneve për të cilat mund të përdoret certifikata, nëse ka.

SHTOJCA II

Kërkesat ligjore për ofruesit e shërbimeve të certifikimit të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara

Ofruesit e shërbimeve të certifikimit:

- (a) duhet të tregojnë besueshmërinë e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të certifikimit;
- (b) duhet të sigurojnë vënien në punë të një liste adresari të gatshëm dhe të sigurt, dhe një shërbim revokimi të sigurt dhe të menjëhershëm;
- (c) duhet të sigurojnë që të përcaktohet me saktësi data dhe ora e lëshimit ose e revokimit të një certifikate;
- (d) duhet të verifikojnë, përmes mjeteve të duhura në përputhje me legjislacionin kombëtar, identitetin dhe, nëse ka, të gjitha atributet specifike të personit të cilit i lëshohet një certifikatë e kualifikuar;
- (e) duhet të punësojnë punonjës të cilët zotërojnë njohuri dhe eksperiencë specialisti dhe plotësojnë kushtet e nevojshme për shërbimet e ofruara, sidomos aftësi në nivel drejtues, njohuri teknike në fushën e teknologjisë së nënshkrimeve elektronike dhe njohuri në fushën e procedurave të duhura të sigurisë; të zbatojnë, gjithashtu, edhe procedurat administrative dhe menaxhuese të cilat të jenë të mjaftueshme dhe t'u korrespondojnë standardeve të pranuar;
- (f) duhet të përdorin sisteme dhe produkte të besueshme, të cilat të jenë të mbrojtura nga ndryshimi dhe të cilat ofrojnë siguri teknike dhe kriptografike të procesit të mbështetur prej tyre;
- (g) duhet të marrin masa kundër falsifikimit të certifikatave dhe, në ato raste kur të dhënat krijuese të nënshkrimit i gjeneron ofruesi i shërbimeve të certifikimit, të garantojnë konfidencialitetin gjatë procesit të gjenerimit të këtyre të dhënave;
- (h) duhet të ruajnë burime financiare të mjaftueshme për të punuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë direktivë, sidomos për të përballuar rrezikun e mbajtjes së përgjegjësisë ligjore për dëmet, për shembull, përmes një kontrate të përshtatshme sigurimesh;
- (i) duhet të regjistrojë të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me një certifikatë të kualifikuar për një periudhë të përshtatshme kohore, sidomos me qëllim dhënien e provës së certifikimit në një procedim ligjor. Këto regjistrime mund të mbahen në formë elektronike,
- (j) nuk duhet të ruajnë apo kopjojnë të dhëna krijuese të nënshkrimeve të personit të cilit i ka ofruar shërbime menaxhimit kyç ofruesi i shërbimeve të certifikimit;
- (k) duhet ta njoftojnë këtë person, përpara lidhjes së një marrëdhënieje kontraktuale me një person, i cili kërkon një certifikatë për të mbështetur të nënshkrimin e vet, përmes një mjeti të qëndrueshëm komunikimi në lidhje me termat dhe kushtet e sakta për sa i takon përdorimit të certifikatës, përfshirë kufizimet e përdorimit të saj, ekzistencën e ndonjë skeme vullnetare akreditimi dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesat. Ky informacion, që mund të transmetohet në mënyrë elektronike, duhet të jepet me shkrim dhe në një gjuhë të kuptueshme. Gjithashtu, u duhen dhënë, sipas kërkesës, palëve të treta, të cilat mbështeten në certifikata, pjesët përkatëse të këtij informacioni;
- (l) duhet të përdorin sisteme të besueshme për ruajtjen e certifikatave në formë të verifikueshme në mënyrë që:

- regjistrimet dhe ndryshimet të mund t'i bëjnë vetëm personat e autorizuar,
- të mund të kontrollohet vërtetësia e informacionit,
- certifikatat të jenë në dispozicion të publikut vetëm në ato raste kur është marrë pëlqimi i titullarit të certifikatës, dhe
- çdo ndryshim teknik i cili komprometon këto kërkesa ligjore për sigurinë, të jetë i dukshëm për operatorin.

SHTOJCA III

Kërkesat për aparatet e krijimit të nënshkrimit të sigurt

1. Aparatet e krijimit të nënshkrimit të sigurt, me anë të mënyrave të përshtatshme teknike dhe procedurale, duhet të sigurojnë të paktën që:

- (a) të dhënat e krijimit të nënshkrimit që përdoren për prodhimin e nënshkrimit në praktikë të shfaqen vetëm një herë, dhe fshehtësia e tyre të sigurohet në mënyrë të arsyeshme;
- (b) të dhënat e krijimit të nënshkrimit që përdoren për prodhimin e nënshkrimit, me një siguri të arsyeshme, nuk mund të përftohen dhe nënshkrimi të ruhet kundër falsifikimit me anë të teknologjisë aktuale të disponueshme;
- (c) të dhënat e krijimit të nënshkrimit që përdoren për prodhimin e nënshkrimit mund të mbrohen në mënyrë të besueshme nga nënshkruesi i ligjshëm kundër përdorimit nga të tjerë.

2. Aparatet për krijimin e nënshkrimit të sigurt nuk duhet të ndryshojnë të dhënat për nënshkrim ose të pengojnë të dhëna të tilla që t'i paraqiten nënshkruesit para procesit të nënshkrimit.

SHTOJCA IV

Rekomandimi për verifikimin e nënshkrimit të sigurt

Gjatë procesit të verifikimit të nënshkrimit duhet të sigurohet në një shkallë të arsyeshme që:

- (a) të dhënat e përdorura për verifikimin e nënshkrimit të korrespondojnë me të dhënat që i jepen verifikuesit;
- (b) nënshkrimi të jetë i verifikuar në mënyrë të besueshme dhe rezultati i verifikimit të paraqitet qartë;
- (c) verifikuesi, sipas nevojës, mund të përcaktojë, në mënyrë të besueshme, përmbajtjen e të dhënave të nënshkruara;
- (d) vërtetësia dhe vlefshmëria e certifikatës së kërkuar në kohën e verifikimit të nënshkrimit të jenë verifikuar në mënyrë të besueshme;
- (e) rezultati i verifikimit dhe identiteti i nënshkruesit të paraqitet qartë;
- (f) përdorimi i një pseudonimi të shfaqet qartë; dhe
- (g) çdo ndryshim që lidhet me sigurimin të zbulohet.